

TOWERS NETWORK ALBANIA Sh.A

Pasqyrat Financiare Individuale

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

Towers Network Albania sh.a.

Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Përmbajtja

Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar	3
Pasqyra Individuale e Performancës	4
Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital.....	6
Pasqyra Individuale e Flukseve të Parasë	7
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	8
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE.....	8
3. POLITIKAT KONTABËL	9
4. MJETE MONETARE.....	13
5.LLOGARI TË ARKËTUESHME	13
6. AKSIONE DHE PJESËMARRJE NË NJËSI TË KONTROLLUARA.....	14
7.AKTIVET AFATGJATA MATERIALE.....	14
8. LLOGARI TË PAGUESHME	15
9. DETYRIMET TATIMORE.....	15
10. HUAMARRJET	15
11. KAPITALI I PAGUAR.....	16
12. TË ARDHURAT.....	16
13. SHPENZIME OPERATIVE.....	16
14. SHPENZIME TË PERSONELIT	17
15. SHPENZIME TË TJERA	17
16. SHPENZIMET PËR TATIMIN MBI FITIMIN	17
17. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA	18
18. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE.....	18

Towers Network Albania sh.a.

Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe
Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar

AKTIVET	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Aktivet Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	384,474	900,558
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	2,902,171	878,855
Parapagime dhe shpenzime të shtyra		-	19,276,258
Total i aktiveve afatshkurtra		3,286,645	21,055,671
Aktivet Afatgjata			
Investimet financiare afatgjata			
Aksione në njësi të kontrolluara	6	351,027,988	1,659,609,988
Aktivet afatgjata materiale			
Aktive afatgjata materiale	7	196,309	133,968
Aktive afatgjata jomateriale	7	73,482	0
Total i aktiveve afatgjata		351,297,779	1,659,743,956
TOTALI I AKTIVEVE		354,584,424	1,680,799,627
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	8	1,380,609	1,222,063,647
Detyrimet tatimore	9	1,389,008	104,410
Huamarrje të tjera afatgjata	10	143,057,609	257,996,022
Totali i detyrimeve		145,827,225	1,480,164,079
Kapitali			
Kapitali aksionar	11	204,840,311	204,840,311
Humbje të mbartura		(4,204,763)	(4,934,210)
Fitimi neto		8,121,651	729,447
Totali i kapitalit		208,757,199	200,635,548
TOTAL I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		354,584,424	1,680,799,627

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga administratori i Shoqërisë më 20 Mars 2019.

Artan Xhori

Administrator

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet bashkë me shënimet në faqet 9 – 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyra Individuale e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra Individuale e Performancës

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhurat			
Të ardhurat nga shitjet	12	10,430,027	2,975,152
Shenzime operative	13	(5,640,176)	(2,913,925)
Shpenzime personeli	14	(3,711,722)	(3,707,081)
Shpenzime amortizimi	7	(50,627)	(36,323)
Totali i shpenzimeve		(9,402,525)	(6,657,329)
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		1,027,502	(3,682,177)
Të ardhura (shpenzimet) financiare, neto	15	8,521,070	4,411,624
Fitimi (humbja) para tatimit		9,548,572	729,447
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		(1,426,921)	-
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	16	8,121,651	729,447

Pasqyra e performancës duhet të lexohet bashkë me shënimet në faqet 9 – 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyra Individuale e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet bashkë me shënimet në faqet 9 – 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i nëshkruar	Rezerva	Humbja e mbartur	Total
Gjëndja më 1 janar 2017	204,840,311	-	(4,934,210)	199,906,101
Kontributet nga pronarët	-			-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-		729,447	729,447
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	204,840,311	-	(4,204,763)	200,635,548
Kontributet nga pronarët	-			-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-		9,548,572	9,548,572
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	204,840,311	-	5,343,809	210,184,120



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyra Individuale e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra Individuale e Flukseve të Parasë

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet bashkë me shënimet në faqet 9 – 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fluksi i parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	9,548,572	729,447
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizim	50,627	36,323
<i>Ndryshimet në:</i>		
- Llogaritë e arkëtueshme	(2,023,316)	240,226
- Shpenzime të shtyra	19,276,258	2,716,400
- Llogaritë e pagueshme	(1,219,398,441)	(2,921,158)
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	(1,192,546,300)	801,238
Fluksi i parave nga veprimtaritë investuese		
Arkëtime nga investimet ne njesi	1,308,582,000	-
Blerja e aktiveve afatgjata të trupëzuara	(186,450)	-
Paraja neto e përdorur në aktivitetet e investimit	1,308,395,550	-
Fluksi i parave nga veprimtaritë e financimit		
Tatim fitimi i paguar	(1,426,921)	
Pagesa e huave	(114,938,413)	(4,271,880)
Rritja e kapitalit aksionar	-	-
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financiare	(116,365,334)	(4,271,880)
(Rënie)/rritje neto në mjete monetare	(516,084)	(3,470,642)
Mjete monetare në fillim të vitit	900,558	4,371,199
Mjete monetare në fund të vitit	384,474	900,557



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Towers Network Albania Sh.a. ("Shoqëria") është themeluar më datë 01 Shtator 2014 dhe është regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit ("QKB") në datën 22 Tetor 2014 me emrin Hightel Towers Albania të cilin e ndryshoi më Shkurt të 2018 në emrin aktual.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve në fushën e transmetuesve radiofonik dhe televiziv, operatorëve të shërbimeve multimediale, shoqërive që operojnë në teknologjinë e komunikimit dhe të Informacionit (ICT) etj.

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është 204,840,311 LEK i përbërë nga 2,048,403 kuota me vlerë nominale 100 LEK secila.

Shoqëria më 31 dhjetor 2018 kishte 2 punonjës (31 dhjetor 2017: 1 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare individuale në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK") për pasqyrat financiare të veçanta me qëllim plotësimin e kërkesave për raportim të pasqyrave financiare ligjore.

Meqënëse SKK-të kërkojnë përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare individuale mund të mos jenë të mjaftueshme për t'u përdorur si pasqyra financiare për qëllim të përgjithshëm për të plotësuar kërkesat e gjithë përdoruesve të pasqyrave financiare. Pasqyrat e konsoliduara të Shoqërisë do të lëshohen pas datës së aprovimit të këtyre pasqyrave.

Shoqëria i mban të dhënat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare të vitit 2018 në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpyetje për t'i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe ajo e matjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në LEK, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetarë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen përgjithësisht në fitime ose humbje.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.1
1 GBP	137.42	149.95



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtaeve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.3 Aktivet afatgjatë

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërësit madhor) më vete të aktivit. Fitimet dhe humbjet në dispozicion të një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të elementit dhe njihen për vlerën neto në zërin "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të aktivit nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të trupëzuara do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.

Kostot e shërbimit të përditshëm të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare për përmirësimet e ambjenteve me qira dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera, gjatë jetëgjatësisë së çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nga dita e parë e muajit pas muajit të blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Jeta e dobishme për periudhën aktuale është si më poshtë:

- | | |
|------------------------------|----------------------------|
| • Ndërtesa | vlera e mbetur me 5% |
| • Automjete | vlera e mbetur me 20% |
| • Pajisje Zyre & Informatike | vlera e mbetur me 20 – 25% |
| • Aktivet jomateriale | vlera e mbetur me 15% |

3.4 Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjëndjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme i referohet çmimit të shitjes që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit, minus të gjitha kostot e vlerësuara për ndërlikimin e biznesit.



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.5 Zhvlerësimi

Aktivet financiare

Aktivi financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidence objektive të zhvlerësimit si pasojë e një apo disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, të cilat kanë ndikim në flukset monetare që rrjedhin nga aktivi financiar dhe që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar i matur me koston e amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së tij të akumuluar dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet e rëndësishme financiare testohen individualisht për zhvlerësim në mënyrë periodikë. Pjesa e mbetur e aktiveve shqyrtohen në grupime që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit.

Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ky anulim lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur kjo humbje. Për aktivitetet financiare të llogaritura me koston e amortizuar, anulimi njihet në pasyrën e të ardhurave.

Aktivet jo-financiare

Vlerat e akumuluar të aktiveve jo-financiare rishikohen në cdo datë raportimi për përcaktuar nëse ka indikacione të zhvlerësimit. Nëse indikacione të tilla ekzistojnë, atëherë duhet të çmohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbja nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e akumuluar e aktivitetit ose e njësisë gjeneruse të mjeteve monetare e tejkalon vlerën

3.6 Provizionet

Provizioni njihet atëherë kur si rezultat i një ngjarje të mëparshme, kompania ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe ekziston mundësia që për shlyerjen e detyrimit do të nevojitet dalja e përfitimeve ekonomike. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset monetare të pritshme me normën para taksave, e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe risqeve specifike të detyrimit.

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat llogariten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për shitjen e mallrave në rrjedhën normale të biznesit, duke marrë parasysh skontimet dhe uljet e ofruara. Të ardhurat njihen kur ofrohen shërbimet.



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kurset e këmbimit.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual i cili njihet në "Pasyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve". Taktimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat e tatimore të aplikuara në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

3.10 Shpërblimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Kompania nuk bën provizione dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi kontributet e paguara në Institutin Shqiptar të Sigurimeve Shoqërore. Kostot respektive në emër të kompanisë njihen në Pasyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, në momentin që ndodhin.

3.11 Vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të mëvonshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethanat aktuale.

Vlerësimet dhe hipotezat që mbartin riskun e shkakimit të një rregullimi material në vlerat e mabrtura të aktiveve dhe detyrimeve për vitin e ardhshëm fiskal, janë të listuara më poshtë.

Taksat mbi të ardhurat

Kompania është subjekt i taksave mbi të ardhurat në Shqipëri. Për të përcaktuar nivelin e taksave të shtyra mbi të ardhurat nevojitet një gjykim i kujdesshëm. Ka një numër transaksionesh dhe llogaritjesh për të cilat një përcaktim përfundimtar i taksave është i pasigurt. Kompania njeh detyrimet për çështje të pritshme që lidhen me auditimin fiskal bazuar në vlerësimet nëse do të ketë taksat shtesë për t'u paguar.

4. MJETE MONETARE

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Para në banka	353,869	885,113
Para në arkë	30,605	15,445
Totali	384,474	900,558



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

5.LLOGARI TË ARKËTUESHME

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme tregtare, klientë	2,902,171	627,000
TVSH e kreditueshme	-	251,855
Tatim fitimi i parapaguar	-	-
Totali	2,902,171	878,855

6. AKSIONE DHE PJESËMARRJE NË NJËSI TË KONTROLLUARA

Ky zë përfshin investimet e shoqërisë në blerjen e aksioneve të palëve të lidhura. Në tabelën e mëposhteme jepet pjesëmarrja në vlerë dhe përqindje deri më datë 31.12.2017.

	31 dhjetor 2018	%	31 dhjetor 2017	%
Plus Network Sh.p.k	351,027,988	100	1,659,609,988	100
Totali	351,027,988		1,659,609,988	

7.AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivitet materiale	Mobilje dhe pajisje zyre	Pajisje Informative	Shpenzime të zhvillimit	Makineri & Pajisje	TOTALI
<i>Kosto</i>					
Më 1 janar 2017	150,000	58,525	-	-	208,525
Shtesa	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	150,000	58,525			208,525
Shtesa	-	-	86,450	100,000	186,450
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	150,000	58,525	86,450	100,000	394,975
<i>Zhvlerësim i akumuluar</i>					
Më 1 janar 2017	25,000	13,234	-	-	38,234
Shpenzime për vitin	25,000	11,323	-	-	36,323
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2017	50,000	24,557			74,557
Shpenzime për vitin	25,000	8,492	12,968	4,167	50,627
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	75,000	33,049	12,968	4,167	125,184
<i>Vlera e mbartur</i>					
Më 1 janar 2017	125,000	45,291	-	-	170,291

Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Më 31 dhjetor 2017	100,000	33,968	-	-	133,968
Më 31 dhjetor 2018	75,000	25,476	73,482	95,833	269,791

8. LLOGARI TË PAGUESHME

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të pagueshme tregtare, furnitorë	1,380,609	1,222,063,647
Totali	1,380,609	1,222,063,647

9. DETYRIMET TATIMORE

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paga të punonjësve	218,502	27,528
Tatimi mbi vlerën e shtuar	183,400	-
Kontributet e sigurimeve	58,593	34,672
Tatim i mbajtur në burim	54,706	-
Tatim fitimi	826,921	0
Tatim mbi të ardhurat nga punësimi	46,886	42,210
Totali	1,389,008	104,410

10. HUAMARRJET

Në këtë llogari janë paraqitur detyrimet e shoqërisë për financimet e marra nga ortakët e saj si edhe nga shoqëria e kontrolluar, për investimet e kryera.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Hua nga TV - KLAN	69,250,098	10,849,518
Hua nga Artan Xhori	23,141,867	10,849,518
Hua nga Plus Network Sh.p.k	11,209,375	12,074,918
Hua nga Top Channel	-	10,848,986
Hua nga UNI - COM	-	10,849,518
Hua nga Samir Mane	-	20,577,735
Hua nga Hightel Towers S.p.A	-	181,795,830
Debitore te tjere	39,456,269	150,000
Totali	143,057,609	257,996,022



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

11. KAPITALI I PAGUAR

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është 204.840.311 LEK i përbërë nga 2.048.403 pjesë me vlerë nominale prej 100 LEK secila. Më poshtë jepet pjesëmarrja në vlerë dhe në përqindje e aksionarëve më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

Aksionari	31 dhjetor 2018	%	31 dhjetor 2017	%
TV - KLAN	153,630,233	75.00%	9,053,928	4.42%
Artan Xhori	51,210,078	25.00%	9,053,928	4.42%
Hightel Towers S.p.A	-	0.00%	151,581,911	74.00%
UNI - COM	-	0.00%	9,053,928	4.42%
Top - Channel	-	0.00%	9,053,928	4.42%
Samir Mane	-	0.00%	17,042,688	8.33%
Total	204,840,311	100%	204,840,311	100%

12. TË ARDHURAT

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura	10,430,027	2,975,152
Totali	10,430,027	2,975,152

13. SHPENZIME OPERATIVE

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Qira	3,684,116	644,000
Shpenzime operative për kullat	808,239	177,786
Konsulenca legale e fiskale	711,050	1,157,340
Mirëmbajtje dhe riparime	237,336	-
Taksa dhe tarifa vendore	69,167	145,674
Shërbime bankare	60,907	45,205
Shpenzime pritje	59,361	350,247
Gjoha dhe dëmshpërblime	10,000	32,956
Të tjera me kupona	-	294,854
Energji elektrike, karburant	-	59,863
Shpenzime telekomunikacioni	-	6,000
Totali	5,640,176	2,913,925

Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

14. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzimet për personelin përfaqësonjë shpenzimet për paga e shpërblime dhe shpenzimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shoqërisë.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Pagat dhe shpërblimet e personelit	3,398,015	3,417,663
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	313,707	289,418
Totali	3,711,722	3,707,081

15. SHPENZIME TË TJERA

Në këtë zë përfshihen të ardhura/shpenzime nga financimet e marra dhe të dhëna, si dhe fitim/humbjet nga këmbimet valutore.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fitim nga interesa bankare	-	-
Fitim nga këmbimet valutore	8,741,929	4,421,580
Humbje nga këmbimet valutore	(220,859)	(9,956)
Totali	8,521,070	4,411,624

16. SHPENZIMET PËR TATIMIN MBI FITIMIN

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin aktual për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është 15%.

	31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	9,548,572
Shpenzime të pazbritshme	59,361
Gjoha	10,000
Fitimi tatimor për vitin	9,617,933



Towers Network Albania sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2018

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e humbjes së mbartur dhe fitimi tatimor per 2018:

Fitim / (Humbje) tatimore 2015	(105,128)
Fitim / (Humbje) tatimore 2018	9,617,933
Fitimi tatimor i akumuluar	9,512,805
Shpenzimet e tatim fitimit	1,426,921
Fitimi tatimor	8,085,884

17. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme:		
TV - KLAN	1,378,720	627,000
Të pagueshme:		
Detyrime ndaj aksionarëve	92,391,965	245,921,104
Plus Network Sh.p.k	11,209,375	12,074,918
Shpenzime:		
Plus Network Sh.p.k	1,380,609	-
Të ardhura:		
TV - KLAN	4,116,720	1,683,000

18. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të ndodhura pas datës së mbylljes së pasqyrave financiare që kërkon rregullime të pasqyrave financiare ose dhënie të shpjegimeve plotësuese për to.

